

UDHËZUES PËR NDALIMIN E KORRUPSIONIT NË VETQEVERISJEN LOKALE

IMPRESUM

Titulli:

Udhëzues për ndalimin e korrupsionit në vetqeverisjen lokale

Editor:

Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë
Shoqata maqedonase e juristëve të rinj

Autorë:

Jasna Orovcaneç Arangjelloviq
Martina Martinova

Koordinim:

Daniela Popovska
Johannes D. Rey

Përtim nga maqedonishtja:

Arben Gudaçi

Dizajn dhe pregaditje:

Vinsent Grafika SHPK Shkup

Vula:

Vinsent Grafika SHPK Shkup

Tirazh:

100 kopje

Fotografi:

Të shkarkuara nga interneti me leje për shkarkim dhe ndryshim

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.kas.de/mazedonien>

<http://myla.org.mk/mk>

Vërejtje:

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim nuk janë të Fondacionit Konrad Adenauer dhe Shoqatës maqedonase së juristëve të rinj, por janë qëndrime personale të autorëve.

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Çfarë është korrupsioni	6
Dispozitat ligjore në lidhje me korrupsionin	7
Parimet themelore në veprimin e zyrtarëve	8
Komisioni shtetëror për ndalimin e korrupsionit	10
Korrupsioni në politikë	12
Korrupsioni në ushtrimin e detyrave publike	14
Korrupsioni në ushtrimin e punëve me interes publik dhe të aktiviteteve të tjera të personave juridik	17
Veprat penale nga fusha e korrupsionit	18



Krimet më të rënda nuk janë kryer për të siguruar gjërat elementare, por me qëllim të grumbullohet "komoditeti" shtesë

Aristoteli

PARATHËNIE

Korrupsioni ka një varg të gjërë të efekteve të dëmshme për shoqërinë. Ajo dëmton rëndë demokracinë dhe sundimin e ligjit, kërcënon cilësinë e jetës, mund të shkaktojë paraqitjen e krimit të rëndë dhe kërcënon sigurinë e të gjithë komunitetit shoqëror.

Lufta kundër korrupsionit nuk është proces i thjeshtë, por nënkupton angazhim të të gjithë komunitetit shoqërorë dhe nismë në të gjitha nivelet. Çdo individ ka obligim moral dhe ligjor të luftojë kundër korrupsionit. Kjo do të thotë jo vetëm njohjen e korrupsionit dhe përmbajtje nga aktet korruptive, por edhe raportimin e rasteve të korrupsionit.


Ky udhëzues është dedikuar nepunësve shtetërorë dhe të punësuarve në organet të vetëqeverisjes lokale – komunat dhe qytetin e Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, kryetarëve të komunave, këshilltarëve në këshillat e komunave, këshilltarëve në Këshillin e Qytetit të Shkupit dhe të punësuarve në agjensionet për punësime të përkohshme me autorizime të caktuara me ligj, si dhe personeve të

cilët punojnë në interes të publikut me rëndësi lokale (persona zyrtarë).

Shpresojmë se ky udhëzues do të arrijë qëllimin për të kontribuar në parandalimin e korrupsionit në vetëqeverisjen lokale dhe për të përforcuar ndërgjegjësimin për dëmet nga aktivitetet e korruptive.

Shprehim mirënjohjen tonë ndaj Fondacionit Konrad Adenauer dhe Ministrisë së shoqërisë Informatike dhe administratës, të cilët identifikuan nevojën për ekzistencën e këtij manuali, si dhe për mbështetjen e madhe të dhënë për realizimin e këtij projekti.

Nga autorët



ÇFARË ËSHTË KORRUPSIONI

Në kuptim më të gjërë të fjalës, korupssioni është shpërdorimi i pushtetit të besuar për qëllime private. Kjo do të thotë që kur ekziston korupssioni, ushtrimi i kompetencave publike dhe punëve në interes publik fitojnë karakter të shërbimeve të disponueshme vetëm për ata qytetarë që kanë mundësi të paguajnë të njejtat.

Individët të cilët sillen në mënyrë korruptive, nëpërmjet shpërdorimit të kompetencave që ushtron, fiton të mira materiale ose jomateriale (për shembull, përfitime të caktuara), të cilat mund të jenë të dedikuara për të ose për dikush tjetër. Në këtë mënyrë, disa individë përfitojnë në mënyrë të paligjshme, përderisa të tjerëve u është vështirësuar realizimi i ndonjë të drejte e cila u takon. Të dy palët në marrëdhënie mund përfitojnë nga korupsioni, ndërsa dëmi ndjehet si pasojë në komunitetin më të gjërë shoqëror.

DISPOZITAT LIGJORE LIDHUR ME KORRUPSIONIN

Ekziston një numër i madh ligjesh lidhur me korrupsionin. Ndër më të rëndësishmit janë: Ligji për parandalimin e korrupsionit, Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Kodi penal, Ligji mbi mbrojtjen e denoncuesve dhe Ligji për lobim.

Në përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit janë të adaptuara Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit dhe Konventa civile për parandalimin e korrupsionit. Republika e Maqedonisë ka ratifikuar keto dokumente dhe ato janë pjesë e legjislacionit të mbrendshëm.

KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

(Sipas Ligjit për parandalimin e korrupsioniot)

Komisioni shtetëror është organ autonom dhe i pavarur në kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj dhe është person juridik.

Komisioni shtetëror është i përbërë nga shtatë anëtarë të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, dhe presidenti zgjedhet nga rradhët e anëtarëve të emëruar. Për anëtar të Komisionit mund të emërohet personi i cili është shtetas i Republikës së Maqedonisë dhe ka vendbanim të përhershëm në R.M., si dhe arsimim të lartë në fushat juridike, çështjet financiare dhe kundër korrupsionit, si dhe te ketë reputacion të mirë për kryerjen e funksionit. Anëtarët e Komisionit shtetëror kanë cilësinë e personit të emëruar dhe janë të detyruar funksionin ta kryejnë në mënyrë profesionale, ndërsa për punën e tyre përgjigjen para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Komisioni shtetëror ka kompetencat të parashikuara me ligj. Ai informon publikun për aktivitetet e ndërmarra dhe rezultatet e arritura. Në qoftë se

para Komisionit shtetëror udhëhiqet procedurë për të sqaruar disa çështje të përcaktuara, të rëndësishme për të sjellur vendim, Komisioni mund të ftojë personin kundër të cilit është duke marrë veprim, si dhe persona të tjerë të cilët mund të kontribuojnë për të qartësuar faktet e një rasti të veçantë.

Komisioni shtetëror mund të kërkon prej cilit do person zyrtar të dhëna dhe raporte mbi asetet e tij ose asetet e anëtarëve të tjerë të familjes, për ndryshimet në asetet, për veprimtarinë që kryen ai ose anëtarë të tjerë të familjes së tij, të ardhurat e gjeneruara si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme, me qëllim parandalimin e korrupsionit.

Komisioni shtetëror të dhëna dhe raporte mund të kërkojë edhe nga organet kompetente ose personave juridik, të cilet janë të obliguar pa vonesë dhe në afat prej 15 ditësh të sigurojnë të dhënat e kërkuara. Në raste kur bëhet fjalë për informacione të klasifikuara trajtohet në bazë të ligjit në fuqi. Në rast se personi përgjegjës nuk i përgjigjet kërkesës së personit juridik, Komisioni shtetëror mund të fillojë procedurë para organit kompetent për përcaktimin e detyrimit të tij.

PARIMET THEMELORE NË VEPRIMIN E ZYRTARËVE

(Në bazë të Ligjit për parandalimin e korrupsionit)

Çdo person zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të tij (funksionin, autorizimin publik, kompetencat zyrtare) ka për detyrë të veprojë në përputhje me Kushtetutën, ligjet, dhe rregulloret e tjera në fuqi, të kryen detyrën e tij në mënyrë të përgjegjshme, profesionale dhe të paanshme. Në kryerjen e veprimeve personi zyrtar nuk guxon të udhëhiqet nga interesi personal ose nga interesi i ndonjë personi tjetër për arritjen e qëllimeve të ndryshme.

Punët që kryen personi zyrtar paraqesin interes publik, janë të hapura dhe i nënshtrohen kontrollit publik. Kjo do të thotë që personi zyrtar ka për detyrë të sigurojë qasje të barabartë në punët që kryen për gjithë publikun.

Nëse eprori i emëruar ose i zgjedhur kërkon nga një zyrtar tjetër të veprojë në kundërshtim me dispozitat në fuqi, personi zyrtar është i obliguar që gojarisht të tregojë se urdhëri është në kundërshtim

me dispozitat, dhe e njëjta konsiderohet si kërkesë e paligjshme. Nëse eprori nuk vepron sipas kesaj vërejtjeje dhe përsërit urdhërin, personi zyrtar duhet menjëherë të njoftojë eprorin e eprorit që ka dhënë urdhërin dhe Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit. Për lajmërimin me shkrim personi i autorizuar nuk mund të thirret në përgjegjshi.

Personi i autorizuar ka detyrim të paraqesë çdo formë të korrupsionit për të cilën është njoftuar gjatë kryerjes së detyrës së tij. Ligji parashikon mbrojtje të personit nëse dërgon deklaratë ose jep dëshmi në procedurë për veprë të korrupsionit, dhe ka të drejtë për shpërblim të dëmit që ai/ajo ose familja e tij/saj ka pësuar si rezultat i deklaratës ose dëshmisë së dhënë.

KORRUPSIONI NË POLITIKË

(Në bazë të ligjit për parandalimin e korrupsionit)

Korrupsioni në politikë mund të jetë prezent gjatë kohës së zgjedhjeve si dhe pas tyre, por gjithashtu mund të jetë prezente edhe në mungesë të zgjedhjeve, gjatë veprimtarisë së partive politike. Në këtë drejtim është e rëndësishme ndalesa e aktiviteteve të partive politike, sindikateve dhe shoqatat e qytetarëve të finansohen nga fondet e buxheteve të njëjstive të vetëqeverisjes lokale.

Gjatë kohës së zgjedhjeve presidenciale, parlamentare ose lokale nuk është lejuar të përdoren mjetet e buxhetit të komunave dhe të qytetit të Shkupit deri në përfundimin e tyre. Kjo gjithashtu do të thotë se është ndaluar edhe fillimi i ndërtimit të objekteve në infrastrukture prej mjeteve buxhetore të komunave, siç janë: rrugë, ujësjellës, linjë elektrike, kanalizime dhe të ngjajshme, si dhe objekte për aktivitete shoqërore, siç janë foshnjoret dhe shkollat.

Ndalesa nuk vlen vetëm në rast se mjetet buxhetore kanë qenë të siguruar më herët, gjegjësisht kur

ndërtimi është pjesë e programës e cila në bazë të ligjit është e sjellur në vitin aktual. Mjetet buxhetore nuk mund të përdoren për pagesa urgjente të pagave, pensioneve, ndihmës sociale dhe pagesa të tjera, ndërsa është e ndaluar edhe shitja e kapitalit shtetëror si dhe firmosja e marrëveshjeve kolektive gjatë kohës së zgjedhjeve.

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit mban llogari për respektimin e ndalesave. Në afat prej tre muajve prej ditës së përfundimit të zgjedhjeve, Komisioni dorëzon Kuvendit raport të posaçëm për keqpërdorimet e mundshme të mjeteve buxhetore. Raporti publikohet edhe në media për informim të publikut.

Personat zyrtarë të cilët veprojnë në kundërshtim të këtyre ndalesave përgjigjen për kundërvajtje, që do të thotë se do të jenë të dënuar me gjoba prej 1000 deri më 2000 euro në kundërvlerë të denarit. Nëse vërtetohet se ekziston një shkallë më e lartë të përgjegjësisë ose është shkaktuar dëm më i madh material, dënimi mund të dyfishohet.

Pas përfundimit të zgjedhjeve, është e ndaluar firmosja e kontratave, prokurimit dhe marrëveshjet tjera mes organeve të vetëqeverisjes lokale dhe personave juridik vendas apo të huaj që sjellin fitim, me anë të së cilave kryhet privilegjim ose diskriminacion. Gjithashtu nuk guxon që me anë të

lejeve, konçesioneve ose vendimeve të ndryshme, disa subjekte juridike të caktuar tu pranohet ose mohohet e drejta ose privilegjet të parashikuara me ligj. Në të dy rastet, Komisioni shtetëror do të ndërmerr masat përkatëse.



KORRUPSIONI NË USHTRIMIN E DETYRAVE PUBLIKE

(në bazë të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit dhe Ligjit për parandalimin e korrupsionit)

Konflikt interesi ekziston atëherë kur kompetencat publike dhe detyrat e personit zyrtar janë në kundërshtim me interesin e tij personal dhe kjo ndikon ose mund të ndikojë në kryerjen e kompetencave dhe detyrave të tij publike. Interesi personal është interes material ose jomaterial i personit zyrtar që mund të ketë efekt në vendimmarrjen e tij gjatë kryerjes së detyrave dhe kompetencave publike, me qëllim përfitimi personal, gjegjesisht pronësor ose drejta e pronësisë apo të drejta tjera që personit nuk duhet ti takojnë.

Në këtë drejtim, bartësit e funksioneve publike nuk guxojnë të kryejnë funksione të tjera, detyrime ose aktivitete të cilat janë kundërshtim me kompetencat e tyre. Ndalesë e ngjajshme ekziston edhe për personat zyrtarë, gjegjesisht ata nuk guxojnë të kryejnë asnjë veprimtari që sjell fitim, çë është në kundërshtim me detyrimet zyrtare të tyre.

Personat zyrtarë gjithashtu nuk guxojnë njëkohësisht të kryejnë funksionin e personit përgjegjës ose të anëtarit të organeve udhëheqëse në ndërmarrje publike, institucion publik ose persone të tjetër juridik të cilët disponojnë me kapital shtetëror. Në rast se zgjidhet ose emërohet si person përgjegjës, ose anëtar i organeve udhëheqëse, personit i ndërpritet funksioni i mëparshëm. Nga e kundërta, në rast se zgjidhet ose emërohet, gjegjësisht me fitimin e cilësisë së personit zyrtarë, personit i ndërpritet funksioni në organet udhëheqëse.

Personi zyrtar ose funksioneri nuk guxon të krijoj marrëdhënie biznesi me person juridik i themeluar nga ai, ose nga një anëtar i familjes, ose nëse personi përgjegjës në personin juridik është anëtar i familjes së tij. Në raste kur marrëdhëniet e biznesit janë krijuara më herët, personi zyrtar ose funksioneri nuk guxon të kyçet në asnjëlloj vendimarrje, dhe ka për detyrë për këtë të njoftojë Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

Personi zyrtar ose funksioneri është i detyruar të përdor fondet shtetërore në mënyrë ekonomike dhe t'i përdor ato siç është paraparë. Është e ndaluar të përdoren fondet shtetërore për qëllime private ose t'i jepen në përdorim dikujt tjetër.

Në rast kur personi zyrtar ose anëtari i familjes së tij është përdorues i huasë shtetërore, kredisë së cilës garancë jep shteti, kredit nga emisionit primar ose nga depozitave shtetërore, është i obliguar menjëher ose në afat prej dhjet ditëve nga fitimi i të huasë/kredisë ta njoftojë Komisionin shtetërorë. Obligimi për njoftim qëndron edhe gjatë shit-blerjes së pronës shtetërore, marrëdhënie juridike e cila lidhet me person juridik themeluar nga ai, apo anëtar të familjes së tij, ose person juridik ku personi përgjegjës është anëtar i familjes së tij. Afati për paraqitje është pesëmbëdhjetë ditë.

Në këtë drejtim, personi i zgjedhur ose i emëruar nuk guxon të ndikojë në punësimin ose avancimin e anëtarëve të familjes së tij në organet ku është i zgjedhur ose i emëruar, apo në organ tjetër shtetëror ose ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror mbi të cilën mbikqyrje kryen organi në të cilin personi është i zgjedhur ose i emëruar.

Personi zyrtar është i detyruar ta njoftojë Komisionin për çdo zgjedhje, emërim, punësim ose avancim të anëtarëve të familjes së tij në organet shtetërore, organet e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror në afat prej dhjetë ditëve prej ditës së zgjedhjes, emërimit, punësimit ose avancimit.

KORRUPSIONI NË USHTRIMIN E PUNËVE TË INTERESIT PUBLIK DHE TË AKTIVITETEVE TË TJERA TË PERSONAVE JURIDIK

(sipas Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike)

Interesi publik është mbështetja ose promovimi i veprimtarive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në promovimin e kultures, etikës, arsimit, shkencës, zhvillimit të shoqërisë informative dhe transferimit të të dhënave elektronike, sportit, mbrojtjes së mjedisit, veprimtarisë sociale-humanitare, zhvillimit të shoqëris civile, promovimit të dhurimit të gjakut, promovimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe veprimtarive të tjera të përcaktuara me ligj. Interesi publik paraqet interes më të gjërë shoqëror për të mirën e përbashkët dhe për prosperitetin e të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë. Prania e korrupsionit nënkupton rrezikimin e interesit publik.

Personat që kryejnë punë me interes publik nuk guxojnë të keqpërdorin kompetencat e tyre për përfitime personale, Komisioni shtetëror mban llogari

për respektimin e kësaj ndalese dhe fillon procedure për shqyrtimin e gjendjes së pronës nëse ekziston dyshim se gjatë kryerjes së punëve në interes publik, gjendja e pronës së personit është ritur në disproporcion përkundër të ardhurave të rregullta ose të ardhurave të anëtarëve të familjes së tij.



VEPRAT PENALE NGA FUSHA E KORRUPSIONIT

(në bazë të Kodit penal të RM-së)

Në bazë të Kodit penal janë parashikuar një numër veprash penale kundër detyrës zyrtare nga të cilave në këtë doracak veçohen: keqpërdorimi i detyrës dhe të autorizimit zyrtar (neni 353), puna e pandërgjegjshme në shërbim (neni 353 c); Abuzim në shërbim (neni 354); Mashtrimi në shërbim (neni 355); Përdorimi i shërbimeve në detyrë (neni 356); Marrja e ryshfetit (neni 357), Dhënie shpërblimi për ndikim të paligjshëm (neni 358-a), Pranimi i shpërblimit për ndikim të paligjshëm (neni 359); Fitimi dhe mbulimi i paligjshëm i pronës (neni 359-a), Zbulimi i fshehtësisë zyrtare (neni 360) dhe Pagesa joligjore.

Keqpërdorimi i detyrës dhe të autorizimit zyrtar

- Keqpërdorimi i detyrës dhe të autorizimit zyrtar ekziston në tre raste:
- Kur personi zyrtar do të përdorë kompetencat apo autorizimet zyrtare për të ndërmarrë një veprim të caktuar;

- Kur personi zyrtar do të tejkalojë kompetencat e tij zyrtare (ndrëmarrja e aktivitetit duhet të ketë karakter zyrtar për të cilën personi nuk ka autorizim. Nuk paraqet tejkalim të kompetencave nëse veprimi nuk ka të bëjë me ndërmarrjen e veprimtarisë zyrtare - për shembull, nëse personi zyrtarë kryen vjedhje ose vepër me lëndime të lehta) ose
- Kur personi zyrtar nuk do të kryejë detyrimet zyrtare.

Në të gjitha rastet, personi zyrtar realizon ndonjë dobi për vete ose për dikënd tjetër ose në dëm të dikujt tjetër. Dobija, gjegjësisht dëmi, mund të jetë e natyrës pronësore ose materiale, por gjithashtu mund të jetë e shfaqur edhe në dobi jomateriale ose dem (për shembull: përdorimi i makinave zyrtare, fitimi pa rend i lokacionit për ndërtim ose banesë dhe të ngjajshme; dëme: dëmtimi i reputacionit dhe nderit dikujt tjetër dhe të ngjajshme). Nën realizim dobi për dikë tjetër nënkuptohet edhe të mirat që i realizon organi ku krzrësi punon. Dënimi për këtë vepër është me burg prej gjashtë muaj deri më tre vjet. Formate më të rënda të kësaj vepre, siç janë përfitimi më i madh ose i konsiderueshëm i dobive, dënohen më rëndë: me burg prej gjashtë muaj deri më tre, gjegjësisht pesë vjet.

Në rast se keqpërdoret kompetenca zyrtare në kryerjen e prokurave ose në dëm të mjeteve buxhetore të Republikës së Maqedonisë, prej fondeve publike, dhe

mjeteve të tjera të shtetit, atëherë dënimi vijon me burg prej më së paku pesë vjet.

Keqpërdorimi i kompetencave dhe autorizimit zyrtar - Personi zyrtar duke përdorur kompetencat e veta ndikon në zgjedhjen e personit udhëheqës (drejtor) i cili është më pak i kualifikuar se kandidatët e tjerë vetëm për të fituar dobi për vete ose me qëllim të dëmton dike prej kandidatëve të tjerë.

Puna e pandërgjegjshme në shërbim

Trajtimi i pandërgjegjshëm mund të jetë prezent në veprimtari me anë të së cilave shkelet një rregullore formale, keqpërdoren autorizimet diskrete ose lëshohet mbikqyrje e detyrueshme. Nën mënyrë tjetër të trajtimit të dukshëm të pandërgjegjshëm nënkuptohen veprimtari të ndryshme të kryerjes së paregullt dhe joetik të shërbimit (në kundërshtim me normat e etikës profesionale të personave zyrtarë për veprim në raste të mundshme të korrupsionit, konflikt interesi). Pasoja e kësaj vepre është përfitim për vete ose për dike tjetër ndonjë dobi. Kodi penal parashikon dënim me burg prej tre muaj deri më tre vjet për trajtim të pandërgjegjshëm të personave zyrtarë.

Abuzim në shërbim

Abuzim në shërbim nënkupton përfitime dobi pronësore të paligjëshme për vete ose për dikush tjetër, në mënyrë që personi zyrtar do të përvetësojë

të holla, letra me vlerë ose mjete të tjera të luajtshme të besuara në shërbim. Për këtë vepër është i paraparë denim me burg prej gjasht muaj deri më tre vjet. Në rast se me kryerjen e kësaj vepre përfitohet dobi më e madhe pronësore ose shkakton dëme më të mëdha pronësore ose në mënyrë të rëndë do të çenohen të drejtat e dikujt tjetër, dënimi është me burg prej gjasht muaj deri më pesë vjet. Në rast kur është fituar dobi pronësore e konsiderueshme, dënimi është me burg prej më së paku katër vjet, ndërsa për dobi të vogël pronësore është e paraparë denim me të holla ose me burg prej një viti.

Mashtrim në shërbim

Personi zyrtar i cili gjatë kryerjes së shërbimit me qëllim për vete ose dikë tjetër të përvetson dobi pronësore të paligjshme do të dorëzon llogari të rejtshme ose në tjetër mënyrë do të sjell habit te personi i autorizuar të bëjë pagesa joligjore, do të dënohet me burg prej gjasht muaj deri më pesë vjet.

Përdorim të shërbimeve në detyrë

Personi zyrtar i cili në mënyrë të pautorizuar do të përdor të hollat, letrat me vlerë ose mjete të tjera të luajtshme të besuara në shërbim ose këto mjete pa autorizim do ti jep në përdorim dikujt tjetër, do të dënohet me burg prej tre muaj deri më pesë vjet.

Marja e ryshfetit

Për ryshfet bëhet fjalë kur personi zyrtar nuk vepron në bazë të ligjit, në suazat e kompetencave dhe obligimeve të tij me qëllim të përvetson për vete ose për dikë tjetër ndonjë dobi. Kjo do të thotë rryshfeti ekziston kur për atë qëllim, personi zyrtar përfiton prej kryerjes së detyrave të tij, gjegjësisht paguhet për kryerjen e detyrave të tij. Me fjalë ndryshe, personi zyrtar nuk guxon të fiton dhurata ose premtim për dhuratë ose dobi tjetër, për të vepruar në mënyrë në të cilën ai duhet rregullisht të kryen punën e tij, e cila mund të përbëhet edhe në mos ndërmarrjen e ndonjë veprimi të cilin është i detyruar ta ndërmerr.

Ryshfeti i këtij lloji dënohet më dënim me burg prej një deri më pes vjet. Ryshfeti ekziston edhe kur personi zyrtar do të veprojë në kundërshtim me ligjin me atë që do të kryen ndonjë veprim të caktuar të cilin nuk ka guxuar ta ndërmerr ose kur nuk kryen ndonjë veprim të cilin ka qenë i obliguar ta ndërmerr. Për këtë vepër është paraparë dënim me burg prej katër deri më dhjetë vjet.

Nëse personi zyrtar kërkon, pranon ose dakordohet të pranon dhuratat apo ndonjë dobi tjetër, pas veprimit në ndonjë menyrë nga të përmendurat më lartë, do të ballafaqohet me dënim prej tre muaj deri më tre vjetë dhe me ndalesë për kryerjen e shërbimit prej një deri më dhjetë vjet. Dhënia e ryshfetit gjithashtu paraqet

vepër penale e cila është në korelacion të ngushtë me pranimin e ryshfetit.

Ryshfet - personi zyrtar në procedurën për dhënien e lejes për ndërtim ose implementimin e planit urbanistik, do të vepron në kundërshtim me rregullat e procedurës dhe do të ndihmon në dhënien e lejes për të cilën ka pengesa për tu dhënë për arsye se personi i interesuar i ka ofruar që do të kryej ndonjë shërbim dhe do të punson dikë të afërt të tij.

Dhënie e shpërblimit për ndikim joligjor

Kur personi zyrtar do të keqpërdorë kompetencat zyrtarë dhe do të përdorë ndikimin e tij për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim të caktuar në suazat e kompetencave të tij me qëllim të ndikojë mbi administratën publike, punësimin, lidhjen e kontratës ose sjelljen e vendimeve (te favorizuar), kryen vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg prej një deri më tre vjet.

Pranimi i dhuratës nga ndikimi joligjor

Personi zyrtar nuk guxon të pranohet shpërblim, dhuratë oapo ndonjë dobi ose premtim ose ofertë për dobi të tillë për vetë apo dikë tjetër, që të përdorë ndikimin e tij real apo të supozuar, kompetencat zyrtare, me qëllim të intervenojë ose të nxit kryerjen e veprimit zyrtar që duhej të kryhet ose të mos kryhet veprim

që nuk duhej të kryhet. Dënimi për këtë veprim është me burg prej një deri më tre vjet.

Në rast se veprimi ka të bëjë me ngritjen apo udhëheqjen e procedurës penale kundër ndonjë personi të caktuar, dënimi është me burg prej një deri më pesë vjet dhe ndalesë për personin zyrtarë të kryejë veprimtari prej një deri më dhjetë vjet.

Fitimi dhe fshehja e paligjshme e pasurisë

Personi zyrtar apo personi përgjegjës në ndërmarrje publike, insitucion publik apo subjekt tjetër juridik i cili disponon me kapital shtetëror ka obligim ligjor të raportoj pasurinë e tij apo ndryshimin e saj, të jep të dhëna të plota dhe të sakta për pasurinë e tij apo të të anëtareve të familjes së tij. Nëse vepron ndryshe, do të dënohet me burg prej gjasht muaj deri më pesë vjet.

Dënimi do të shqiptohet në momentin kur do të vërtetohet se gjatë ushtrimit të funksionit apo detyrës, personi apo pjestari i familjes së tij ka fituar pasuri në një vlerë të konsiderueshme që tejkalon të ardhurat e tij ligjore, ka dhëna të dhëna të reme apo ka fshehur burimet e verteta të të ardhurave. Përveç dënimit, parashikohet edhe konfiskimi i pasurisë.

Komunikimi i paautorizuar i sekretit zyrtar

Personi zyrtar i cili në publik apo personit të paautorizuar ia kumton, percjell ose në ndonjë mënyre tjetër mundëson qasje në të dhëna të cilat paraqesin sekret zyrtar, ose mbledh të dhëna të tilla me qëllim që t'ia kumton apo percjell personit të paautorizuar ose në publik, dënohet me burg prej tre muaj deri më pesë vjet.

Sekrete zyrtar llogariten te dhënat dhe dokumentet të cilat me ligj apo me dispozite tjetër ose me vendim të organit kompetent të nxjerra në pajtim me ligjin, janë të shpallura si sekret zyrtar dhe zbulimi i të cilave ka apo mund të ketë pasoja për shërbimin. Kushdo që komunikon sekret zyrtar nga lakmia apo për përdorimin e tyre jashtë vendit, dënohet me jo më pak se një vjet.

Komunikim i sekretit zyrtar nga lakmia – Personi zyrtar i cili në menyrë të paautorizuar i mundëson qasje palës së interesuar në ndonjë dokument i cili paraqet sekret zyrtar, në këmbim të një shumë të caktuar parash.

Pagesa joligjore

Personi zyrtar i cili gjatë kryerjes së detyrës zyrtare kërkon nga personi tjetër të paguaj një shumë të caktuar, të cilën shumë ai nuk është i obliguar ta paguan, ose kërkon më shumë se shuma të cilën ai

është i obliguar ta paguaj, apo gjatë pagesës ose dorëzimit të sendeve, personi zyrtar paguan ose dorëzon me pak se që është i obliguar, dënohet në të holla ose burgim deri në tre vjet.

BURIMET E PËRDORURA:

Ligji për parandalimin e korrupsionit

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit

Konventa civile për parandalimin e korrupsionit

Tupaçeski (2015) „E drejta penale ekonomike”, Shkup

[http://www.dksk.org.mk/index.php?option=com_content
&task=view&id=23&Itemid=43](http://www.dksk.org.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=23&Itemid=43)

<https://www.akademika.com.mk/>

<http://www.dksk.org.mk/>



Konrad
Adenauer
Stiftung

**Fondacioni Konrad Adenauer
Zyrja në Maqedoni**

Rr. "Risto Ravanovski" nr. 8
1000 Shkup

Tel: +389 2 3217 075

Fax: +389 2 3217 076

e-mail: skopje@kas.de

www.kas.de/mazedonien



Македонско здружение на млади правници

Shoqata maqedonase e juristëve të rinj

Rr. "Donbas" nr. 14/1-6
1000 Shkup

Tel: +389 2 3220 870

e-mail: contact@myla.org.mk

www.myla.org.mk



Република Македонија
Министерство за Информатичко
Општество и Администрација

**Ministria për Shoqëri Informatike
dhe Administratë**

Rr. "Shën Qirili dhe Metodi" nr. 54
1000 Shkup

e-mail: contact@mioa.gov.mk

www.mio.gov.mk

